MARRËVESHJE

Referuar Kontratës së Koncensionit

të formës "BOT" për ndërtimin dhe administrimin e impjantit

të trajtimit te mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë

Bazuar në Kontratën Koncensionare me Nr. Prot. 5553/5, datë 24.10.2016 " Për ndërtimin dhe administrimin e impjantit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë", e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit (kaluar për kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k., mbi bazë të kërkesës së Supervizorit të kontratës koncensionare shoqërisë "AVE Consulting" sh.p.k dhe subjektit "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k., pikës 25 "Ndryshime", pikës 6 "Marrëveshjet (Faza Para Ndërtimore dhe Ndërtimore)" dhe Autorizimit Nr. 5583/4 Prot., datë 31/08/2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe bazuar në si më poshtë:

A. Referuar Aneksit IV të Kontratës "Grafiku i Punimeve" ku përcaktohen afatet për fazën e ndërtimit të impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë.
B. Sipas përcaktimin në Autorizimin Nr. 5583/4 Prot., datë 31/08/2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ku përcaktohet i) kërkesa për shtyrje të afatit të punimeve nga ana e shoqërisë koncensionare "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 19/2 Prot., datë 22/07/2020, ii) Njësia e Zbatimit të Projektit shpreh dakortësinë për shtyrjen e periudhës së ndërtimit iii) autorizon titullarin e lartë të Agjencisë Kombëtare Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) dhe duke e përcaktuar AKUM si Autoritet të Autorizuar për nënshkrimin e dokumentit/ aktit të nevojshëm bazuar në kërkesën e shoqërisë koncensionare.

C. Referuar, Nenit 25 të Kontratës së Koncensionit " Për ndërtimin dhe administrimin e impjantit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë" pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Termat bazuar në sipërcituar:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të njihet si *Autoritet Kontraktor*

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës sës Mbetjeve do të njihet si *Autoritet Autorizuar*

Shoqëria "Integrated Technology Waste Treatment Fier" do të njihet si *Koncesionari*

Palët e mbledhura në Tiranë më 11/09/2020, si më poshtë vendosin:

Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, e autorizuar nga Autoriteti Kontraktues, i përfaqësuar nga Z. Alqi Bilako, Drejtor i Përgjithshëm, në vijim **"Autoritet i Autorizuar"**

Dhe

Shoqëria "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k (SPV Integrated sh.p.k NIPT L62205045F) me seli qëndrore në Tiranë, me adresë Rr. "Papa Gjon Pali II", P/F&G, Ap/15 dhe me administrator Z. Loran Dusha, me shtetësi shqiptare, në vijim **"Koncesionari"**

vendosën dhe ranë dakord të lidhin këtë marrëveshje me parashikimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Miratimin për zbatim të Grafikut të Punimeve, si bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje në të cilin përcaktohen afatet e reja për ndërtimin e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë.

Neni 2

Referuar parashikimit të Nenit 1 bashkëlidhur këtij aneksi gjendet Grafiku i punimeve i rishikuar që pasqyron afatet e reja për ndërtimin e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë.

Afati përfundimtar i kësaj marrëveshjeje do të jetë data 31 Mars 2021.

Neni 3

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje, me nga 3 (tre) fletë secila, të cilat kanë të njëjtën vlerë midis tyre.

Neni 4

Marrëveshja do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëvë në përputhje me pikën 32 të Kontratës së koncesionit dhe bëhët pjesë e pandarë e Kontratës se koncesionit në përputhje me paragrafin 25.2 të kësaj Kontrate. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet nënshkrimi si datë e hyrjes në fuqi.

Neni 5

Çdo ndryshim jo i parashikuar në këtë marrëveshje, me dakortësi paraprake mes palësh do të jetë shtesë marrëvështje dhe konsiderohet si pjesë integrale e saj, nga momenti i firmosjes nga personat e autorizuar për secilin subjekt.

Për: Autoritetin e Autorizuar

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

SHQIPËRI

Për: Koncesionarin

"Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k

Z. Loran Dusha

ADMINISTRATOR

GRAFIKU I RISHIKUAR I PUNIMEVE

Objekti: Dhenia me koncesion e ndertimit e administrimit te Impiantit te Trajtimit te mbetjeve urbane te Qarkut Fier dhe prodhim energjie ,

Shtyrja e afatit deri ne 31 Mars 2021, me + 8 MUAJ

Nr.	Emertimi I punimeve	Njesia	PREVENTIVI Sasia	Periudha e punimeve 37 Muaj
				1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20 21 22 23 24 25 26 27 28 29 30 31 32 33 34 35 36 37
A	**PUNIME CIVILE**			
	Impianti I perpunimit (termovalorizatori)			
1	Punime civile per termovalorizatorin	cope	1	
	Vend depozitimi			
1	Rrafshim skarpate me germim me ekskavator 1m3.	m2	50,000	
2	Mbushje me material inert me karakteristika sipas projektit me shtresa me ngjeshje per realizimin e arginatures se vend depozitimit dhe vaskave te ujit	m3	127,000	
3	Realizimi I barieres natyrore me argjile me shtresa te ngjeshura me spesor 1m ne fund te vaskes dhe ne paretet e saj sipas karakteristikave te projektit te germuar ne karriere dhe te transportuar ne vendin e ndertimit distance 10km.	m3	50,000	
4	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeokompozit bentonitik	m2	50,000	
5	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeomembrane HDPE me spesor 2.50 mm	m2	50,000	
6	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeotekstil me fibra polipropileni me densitet 800gr/m2	m2	50,000	
7	Tuba drenazhi me vrima HDPE PN10 se bashku me rakorderite	ml	1,300	
8	Pus per mbledhjen e ujrave te ndotur f1000	cope	2	
9	Tub per dergimin e ujrave te ndotur ne impiantin e trajtimit HDPE f200 PN10	ml	150	
10	Pompe zhytese se bashku me panelin elektrik sipas specifikimeve ne projekt	cope	2	
11	Shtrese drenazhi e realizuar me zhavor te lare 30-70 me spesor 50cm	m3	12,000	
12	Kolaudimi gjeoelektrik per verifikimin e pershkueshmerise se ujit ne shtresat e realizuara	vlere	1	
13	Instalimi I piezometrave per monitorimin e ujrave nentoksore	cope	4	
14	Specifikime teknike, analiza laboratorike, kolaudime, certifikime etj	vlere	1	
	Impianti I perpunimit te ujrave te ndotur			
1	Rrafshim skarpate me germim me ekskavator 1m3.	m2	7,000	
2	Mbushje me material inert me karakteristika sipas projektit me shtresa me ngjeshje per realizimin e arginatures se vend depozitimit dhe vaskave te ujit	m3	17,500	
3	Realizimi I barieres natyrore me argjile me shtresa te ngjeshura me spesor 1m ne fund te vaskes dhe ne paretet e saj sipas karakteristikave te projektit te germuar ne karriere dhe te transportuar ne vendin e ndertimit distance 10km.	m3	7,000	
4	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeokompozit bentonitik	m2	7,000	
5	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeomembrane HDPE me spesor 2.50 mm	m2	7,000	
6	Realizimi I barierave artificiale sipas shtresave: Gjeotekstil me fibra polipropileni me densitet 800gr/m2	m2	7,000	

Nr.	Emertimi i punimeve	Njesia	PREVENTIVI Sasia	Periudha e punimeve 37 Muaj
				1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20 21 22 23 24 25 26 27 28 29 30 31 32 33 34 35 36 37
7	Kolaudimi gjeoelektrik per verifikimin e pershkueshmerise se ujit ne shtresat e realizuara	viere	1	
8	Punime civile per impiantin e pastrimit te ujrave te ndotur	viere	1	
	Sheshe, rruge aksesi etj.			
1	Punime civile per ndertim sheshesh operimi	viere	1	
2	Punime per ndertim rrugesh aksesi	viere	1	
3	Punime civile per ndricim ambjenti	viere	1	
4	Rrethimi I objektit	viere	1	
5	Sistemime dhe gjelberime	viere	1	
	Taksa e ndikimit ne infrastrukture			
B	**MAKINERI DHE PAISJE ELEKTROMEKANIKE**			
	Impianti I perpunimit (termovalorizatori)			
1	Kaldaja	cope	1	
2	Turbina	cope	1	
3	Komponentet (tubat, flanxhat, kthesat, T, etj)	cope	1	
4	Valvulat manuale dhe automatike	cope	1	
5	Pjesa elektrike (bordi qendror dhe paisjet elektrike)	cope	1	
6	Paisjet e instrumenteve, rregullatoret, indikatoret etj.	cope	1	
7	Sistemi I menaxhimit dhe kontrollit	cope	1	
8	Dhoma e kontrollit	cope	1	
9	Montime mekanike dhe elktrike	viere	1	
10	Kolaudimi I impiantit	viere	1	
	Impianti I perpunimit te ujrave te ndotur			
1	Komponentet mekanik, tuba, flanxha, valvula etj.	viere	1	
2	Pjesa elektrike	viere	1	
3	Impianti I pastrimit te ujrave te ndotur	cope	1	
	Sheshe, rruge aksesi etj.			
1	Punime per ndricim ambjenti	viere	1	
C	**LIDHJA ME SISTEMIN ELEKTROENERGJITIK**			
1	Pjesa elektrike (shtyll elektrike, kabina, cela, kabuj etj)	cope	1	
2	Montime elektrike	viere	1	
D	**KOSTO STUDIMI I PROJEKTIT**			

Per Investitorin
" INTEGRATED TECHNOLOGY WASTE TREATMENT FIER " SHPK
ADMINISTRATOR
LORAN DUSHA

Mbikqyresi I Punimeve
"AVE CONSULTING" sh.p.k
ADMINISTRATOR
Ing.ARBEN DERVISHAJ